



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 788/ Prot

Elbasan, më 17.07.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË BELSH

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.35, datë 14.07.2025 "Për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 faza e I^{-rë}", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2544 Prot

Belsh më 15/07 /2025

VENDIM

NR. 35 DATË 14 / 07 / 2025

PËR

"Miratimin e Projekt Buxhetit Afatmesem 2026-2028 faza e I"

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr.68/2017 dt.27/04/2017 "Për Financat Vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e programit Buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028".

Me propozim nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave të Bashkisë Belsh, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë Fazën e I të PBA 2026-2028, sipas tabelës dhe relacionit bashkangjitur.
2. Ky vendim u miratua me 11 vota pro dhe hyn në fuqi sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

KRYETARI I KËSHILLIT

Kujtim DËRVISHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE, TË ARDHURAVE VENDORE DHE ZYRËS NDIHMËS
EKONOMIKE

PROJEKT -VENDIM

Nr. 2506 DATE 14/07/ 2025

"Miratimin e Projekt Buxhetit Afatmesem 2026-2028 faza e I"

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr.68/2017 dt.27/04/2017 "Për Financat Vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e programit Buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028".

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave të Bashkisë Belsh i propozon Këshillit të Bashkisë Belsh si më poshtë:

1. Të miratojë Fazën e I të PBA 2026-2028, sipas tabelës dhe relacionit bashkangjitur.

Juristi

Desara MUSTA

Drejtoria e Finances

Alban NIPOLLI

Kryetari i Bashkisë

Arif TAFANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. — .Prot

Belsh më: 14 .07.2025

RELACION

“Mbi hartimin e dokumentit Te Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 Faza e I”.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 8 datë 28/02/2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”. Bashkia Belsh mori te gjitha masat për hartimin e Projekt Buxhetit 2026-2028 duke u bazuar në të gjitha kriteret e përcaktuara nga udhëzimi i mësipërm. Për hartimin e Projekt - Buxhetit 2026-2028 duhet të ngrihet sipas Udhëzimit Nr.8 date 28.02.2025 grupi për menaxhimin strategjik (GMS) i cili duhet te zbatoje me korrektësi te gjitha kriteret dhe kërkesat qe janë përcaktuar ne këtë udhëzim, dhe afatet sipas programit të punës. Duke u bazuar në udhëzimet e ardhura për këtë qëllim Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të përcaktojë prioritetet kryesore për periudhën 2026-2028.

Gjatë hartimit të Projekt Buxhetit si për burimet financiare dhe shpërndarjen e tyre janë mbajtur parasysh të gjitha prioritetet më te domosdoshme për periudhen 2026-2028, duke evidentuar dhe planifikuar të gjitha burimet e mundshme financiare të vetë Bashkisë dhe burimet financiare të ardhura nga transfertat e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar si fondet e tjera te ardhura nga fondi i zhvillimit rajonal, Akum etj. Gjatë hartimit te Projekt buxhetit janë bërë takime me grupet e interesit dhe komunitetin dhe të gjitha kërkesat dhe prioritetet e dala ju paraqiten Nënpunësit e Autorizuar. Në hartimin e burimeve financiare te Bashkise Belsh janë mbajtur parasysh të gjitha udhëzimet dhe ligjet për taksat vendore dhe mbi këtë baze janë parashikuar te ardhurat dhe shpenzimet. Ndërsa për transfertën e pakushtëzuar për cdo vit 2026-2028 është mbajtur parasysh kriteri i përcaktuar ne udhëzimin nr.8 date 28.02.2025. Me poshtë po trajtojmë disa nga treguesit më kryesor të tavanëve:

Për sa i përket shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2026-2028 janë bërë mbi bazën e të gjitha nevojave dhe prioritetet më të domosdoshme në përputhje me burimet financiare që ka në dispozicion Bashkia. Shpenzimet më të mëdha janë planifikuar në ato struktura buxhetore që janë më të rëndësishme dhe sidomos në investime.

Struktura e programeve te buxhetit vendor Belsh do te jete si me poshtë:

<u>Nr</u>	<u>Funksioni</u>	<u>Nr</u>	<u>Nen/funksioni</u>	<u>Nr</u>	<u>Programi</u>
1	PLANIFIKIMI, MANAXHIMI DHE ADMINISTRIM	011	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare fiskale dhe çështjet e brendshme PAK dhe ndihma ekonomike	01110 01170 10430	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim Gjendje Civile PAK
2	RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	031	Shërbime Policore	03140	Shërbimet e Policisë Vendore
		032	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
		010	Shërbimet e Emergjencës	10910	Emergjencat civile
3	MBESHTETJE PER ZHVILLIM EKONOMIK DHE MIRMBAJTJA E RRUGEVE	042	Ujta/Kullimi	04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe Kullimit
		045	Mirmbajtja e Rrugeve/Projektet	04520	Rrjeti Rrugor Rural
4	SHERBIMET PUBLIKE VENDORE DHE MBROJTJA E MJEDISIT	062	Shërbimet Publike	06260	Shërbime Utilitare në dobi të Komunitetit
		042	Pyjet	04260	Menaxhimi dhe Mirmbajtja e Fondit Pyjor
5	ARSIMI KULTURA DHE SPORTI	091/ 092	Arsimi Baze dhe i Mesëm	06180	Arsimi baze dhe i Mesëm
		082	Kultura	08220	Aktivitete të ndryshme kulturore artistike.

Persa i përket shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2026-2028 janë bërë mbi bazën e të gjitha nevojave dhe prioritetëve me të domosdoshme në përputhje me burimet financiare që ka në dispozicion Bashkia. Shpenzimet më të mëdha janë planifikuar në ato struktura buxhetore që janë më të rëndësishme dhe sidomos në investime.

Totali i shpenzimeve sipas viteve paraqitet si më poshtë:

000/mijë lekë

<u>Nr</u>	<u>EMERTIMI</u>	<u>2023</u>	<u>2024</u>	<u>2025</u>	<u>2026</u>	<u>2027</u>	<u>2028</u>
1.	Tot.Shpenzimeve	1,145,579	817,391	518,436	525,245	536,295	439,605

Sic shikohet nga të dhënat e mësipërme për vitin 2025 shpenzimet janë bërë mbi bazën e planifikimit të të ardhurave të veta të Bashkisë, nga transfertat dhe të ardhura të trashëguara nga viti 2024 dhe nga transfertat të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara që gjenerohen nga Qeveria për vitin aktual. Ndërsa Planifikimi afatmesëm i të ardhurave dhe Shpenzimeve për periudhën 2026-2028 është bërë mbi bazën e një niveli rritjeje prej 1% që na lejon udhezimi nr. 8 datë 28.02.2025 për transfertën e pakushtëzuar sektoriale, parashikimin e të ardhurave afatmesme të bera nga sektori i taksave në Bashkinë Belsh dhe transfertën e pakushtëzuar që sjell qeveria për planifikimin afatmesëm.

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitet 2026-2026 paraqiten si më poshtë :

000/mijë lekë

Nr	E M E R T I M I	2023	2024	2025	2026	2027	2028
1.	Shp. Page	167,551	186,629	254,664	258,031	265,981	272,011

Përqindja që zënë shpenzimet për pagat e ndaj totalit të shpenzimeve:

000/mijë lekë

N r	E M E R T I M I	2023	2024	2025	2026	2027	2028
1.	%Pagave+ sig.shoqerore	15%	22.8%	49%	49%	50%	61.8%

Sic është përmendur edhe më lartë në hartimin e Projekt Buxhetin 2026-2028 prioriteti kryesor kanë qenë shpenzimet për investime si me burimet financiare nga vete Bashkia dhe financimet nga donatorë të tjerë. Në këtë Projekt Buxhet tre prioritete kryesore janë Investimet në Ujitje dhe Kullim, arsim dhe Investimet në infrastrukturë, rrugët rurale.

Për investimet është planifikuar një fond i konsiderueshëm kështu për vitin 2026 janë planifikuar 18% te totalit të shpenzimeve, për vitin 2027 janë planifikuar 17 % te totalit të shpenzimeve dhe për vitin 2028 janë planifikuar 21.5% te totalit të shpenzimeve.

Këto ishin tavanet e planifikuar për të ardhurat dhe shpenzimet për PBA-së 2026-2028, me kërkesat dhe propozimet që do të bëhen nga anëtarët e këshillit do të përfshihen në PBA përfundimtare dhe brenda datës 1 Qershor do të dërgohen Ministrisë së Financave do të bëhen përmirsimet e nevojshme dhe do të paraqiten në Këshillin Bashkiak për miratimin Përfundimtar të PBA-së 2026-2028.

Specialiste Finance

Dr/Financës

Kryetari

Ornela URUÇI

Alban NIPOLLI

Arif TAFANI





Nr 2258.prot
25/06/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Dr. Financa
ETI

Zaj. Ohri

9739

Nr. _____ prot.:

Tiranë, më 18.6.2025

Lënda: Dërgohen mendimet mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028

BASHKISË BELSH *V*

KËSHILLIT TË QARKUT _____

Në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar dhe të udhëzimit vjetor të Ministrit të Financave nr.8 datë 28.02.2025, "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", bashkëlidhur ju dërgojmë komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave mbi projekt-dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije që procesi dhe procedura e vazhdimit të fazës së dytë për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor do të zbatohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja
Besmir Beja



Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit". Nd. 3, 1001. Tiranë, <https://www.financa.gov.al>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

ANALIZA E PBA 2026-2028

BASHKIA BELSH

I. Vështrim i Përgjithëm

Procesi i Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA) ofron një qasje të integruar dhe të strukturuar për menaxhimin financiar të njësive vendore, duke shmangur përpjekjet fragmentare dhe duke siguruar një lidhje të qartë mes parashikimeve të të ardhurave, pra burimeve financiare në dispozicion, dhe shpenzimeve të nevojshme. Ky proces përcakton në mënyrë të qartë objektivat për shpenzimet publike, duke identifikuar kostot e domosdoshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet, në përputhje me strategjitë dhe prioritetet e politikave lokale. Përmes këtij procesi, hartohet një lidhje e fortë midis qëllimeve të politikës së programit dhe objektivave të bashkisë, duke siguruar që çdo vendim buxhetor të jetë i mbështetur nga analiza strategjike dhe të parashikohen në planifikimin afatmesëm. PBA-ja disiplinon dhe forcon maturinë financiare të administratës vendore, duke planifikuar shpenzimet publike në një kuadër realiste dhe të qëndrueshëm financiarisht. Ajo gjithashtu synon të sigurojë që ofrimi i shërbimeve publike të përmbushë nevojat në rritje të banorëve, duke treguar se si shpenzimet prioritare strategjike për zhvillimin e njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetorë të shpenzimeve. Pavarësisht se dokumenti në mënyrë zyrtare është paraqitur tek Ministria e Financave jasht afateve të përcaktuara në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", elektornikisht ky dokument është dorëzuar në afat. Vlerësojmë punën e bërë nga ana e bashkisë Belsh në hartimin e PBA-së për vitet 2026-2028, e cila është realizuar nëpërmjet "Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor". Kërkesat e kërkuara në udhëzimin nr.8, datë 28.02.2025, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028", përgjithësisht janë plotësuar, duke përfshirë përcaktimin e qëllimeve të politikës së programit, objektivave, treguesve të performancës në nivel qëllimi dhe objektiv, si dhe produktet e parashikuara sipas programeve buxhetore. Gjithashtu, janë përcaktuar dhe analizuar kostot e produkteve të identifikuar në kuadër të programeve buxhetore, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave të programit. Bashkia Belsh ka bërë përpjekje të dukshme për të përditësuar informacionin mbi strukturën organizative, numrin e punonjësve, njësitë shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe detyrimet e prapambetura, gjithashtu në përputhje me formatet e përcaktuara në Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor. Referuar përcaktimit të produkteve, vlerësojmë pozitivisht punën e bashkisë Belsh, e cila përgjithësisht është në përputhje me shtojcën nr. 5, "Metodologjia e re e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028", të udhëzimit vjetor të MF-së, së lartpërmendur me disa përjashtime. Në vazhdim, bashkia Belsh ka raportuar edhe mbi projektet e investimeve.

II. Lista e Programeve të NJQV-së

Programet buxhetore të përdorura nga bashkia Belsh për PBA 2026-2028, paraqiten si më poshtë:

- AA152 - Planifikimi, Manaxhimi dhe Administrimi;
- AB152 - Rendi dhe Siguria Publike;
- AC152 - Manaxhimi për Zhvillimin Ekonomik dhe Mirëmbajtja e Rrugëve;
- AD152 - Shërbimet Publike Vendore dhe Mbrojtja e Mjedisit;
- AE152 - Arsimi, Kultura dhe Sporti;
- AF152 - Fondi Rezervë dhe Kontigjenca.

III. Komente të Përgjithshme

- Bashkia Belsh e ka paraqitur në MF programin buxhetor afatmesëm elektornikisht brenda afateve të përcaktuara në ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar";
- Programi buxhetor afatmesëm për periudhën 2026-2028, është përgatitur nga bashkia Belsh sipas metodologjisë së re të përcaktuar në udhëzimin vjetor për përgatitjen e PBA-së si dhe nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit Buxhetor;
- Programet buxhetore të përdorura nga bashkia Belsh janë në përputhje me përcaktimet e Shtojcës 5, të udhëzimit nr.8, datë 28.02.2025, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028";
- Produktet përgjithësisht janë në përputhje me Shtojcën 5, të udhëzimit udhëzimin nr.8, datë 28.02.2025, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028", me disa përjashtime;
- Bashkia Belsh, ka plotësuar të gjitha formatet e SMBV-së, përfshi këtu edhe strukturën organizative, numrin e punonjësve, detyrimet e prapambetura, njësit shpenzuese të NJVQV-së, si dhe të dhënat bazë mbi NJVQV-n.

IV. Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore

Tendenca e të ardhurave në vite:

Të ardhurat e bashkisë Belsh janë parashikuar nga burimet e veta si dhe nga transfertat e buxhetit qendror. Në këtë analizë janë përjashtuar fondet nga transfertat e Kushtëzuar.

- Për vitin 2026, të ardhurat totale të bashkisë Belsh janë parashikuar me rritje me 3% krahasuar me buxhet 2025, nga të cilat të ardhurat e veta paraqiten me parashikim me rritje me 2%.

- Për vitin 2027, të ardhurat totale të bashkisë Belsh janë parashikuar me rritje po me 3% krahasuar me vitin 2026, nga të cilat të ardhurat e veta janë parashikuar me rritje me 1%.

- Për vitin 2028, të ardhurat totale të bashkisë Belsh janë parashikuar me rritje me rreth 2% nga ku të ardhurat nga burimet e veta paraqiten me parashikim me rritje me 0.2%

Konstatohet se, pjesa më e madhe e buxhetit të bashkisë Belsh për të tre vitet e PBA-së parashikohet nga transfertat e buxhetit qendror. Për të shmangur varësinë e lartë nga transfertat nga buxheti qendror dhe për të krijuar një bazë të qëndrueshme financiare, bashkia Belsh duhet të fokusohet në diversifikimin e burimeve të të ardhurave dhe përmirësimin e kapaciteteve të veta financiare. Kjo do të nxiste zhvillimin ekonomik lokal, do të rrisi investimet kapitale dhe do të përmirësonte shërbimet për qytetarët.

Analiza e shpenzimeve buxhetore në nivel llogarie ekonomike në vite në mijë lekë:

Shpenzimet sipas kategorive	2025	2026	2027	2028
Shpenzime Personeli (600-601)	249,356	258,032	265,981	271,011

Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	79,424	82,050	85,150	87,755
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	78,072	78,072	78,071	80,838
Totali	406,852	418,154	429,202	439,604

Referuar tabelës së mësipërme konstatojmë se shpenzimet ndjekin të njëjtin trend me të ardhurat, me parashikim me rritje me 3% në vitin 2026 krahasuar me vitin 2025, po me rritje me 3% në vitin 2027 krahasuar me vitin 2026, si dhe me rritje me 2% në vitin 2028 krahasuar me 2027.

Shpenzimet e personelit (600+601)

Shpenzimet e personelit parashikohet të zënë rreth 62% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për secilin vit të PBA-së.


Shpenzimet Operative dhe të tjera (602-609-651,1661)

Shpenzimet operative dhe të tjera parashikohet të zënë rreth 20% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për secilin vit të PBA-së.

Shpenzimet për Investime (230-232,255)

Për vitin 2026, janë parashikuar shpenzim për investime kapitale në masën 19% të totalit të shpenzimeve, ndërsa për vitin 2027 dhe 2028 ato parashikohen të zënë rreth 18%, duke reflektuar një prioritizim të ulët të investimeve në planin buxhetor. Kjo situatë tregon për një qasje të munguar ndaj zhvillimit afatgjatë, duke lënë pas dore potencialin e madh që investimet kapitale kanë për të ndryshuar dhe për të avancuar nivelin e shërbimeve publike, infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik vendor. Në këtë kontekst, është thelbësore që, gjatë fazës së dytë të procesit të rishikimit buxhetor, të bëhet një vlerësim i kujdesshëm i zërave të buxhetit, duke parë se pjesa më e madhe e fondëve aktualisht shkojnë për shpenzime të lidhura me personelin. Është e domosdoshme që të jepet prioritet i veçantë për investimet kapitale, pasi ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve të qyteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore, përmirësimin të infrastrukturës publike dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal. Për më tepër, alokimi i burimeve për investime është një faktor vendimtar për të arritur standarde më të larta të jetesës për qytetarët dhe për të siguruar që shërbimet që ofrohen aktualisht të jenë në nivelin e pritshëm nga komuniteti. Prandaj, është e një rëndësie të lartë që të rishikohet dhe të rritet përqindja e zërave të investimeve kapitale në PBA, duke synuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar, i cili do të ndikojë pozitivisht në mirëqenien e përgjithshme të komunitetit dhe në perspektivën afatgjatë të qytetit.

Analiza e shpenzimeve buxhetore sipas funksioneve në vite:



Për të tre vitet e PBA-së, funksionet më të financuara janë “Shërbimet e Përgjithshme Publike”, “Arsimi” si dhe “Cështjet ekonomike”.

V. Projektet prioritare të investimeve në periudhën afatmesme

Ndërsa parashikimi i investimeve për periudhën 2026-2028 përmban projekte të parashikuara për tu iniciuar gjatë këtyre viteve të tilla si “Rikonstruksionin e godinave të institucioneve të bashkisë Belsh” dhe “Rikonstruksionin e shkollave 9-vjeçare në bashkinë Belsh” ky fokus i vetëm në infrastrukturën administrative dhe arsimore nuk është i mjaftueshëm për të sjellë ndryshime të dukshme në zhvillimin dhe mirëqenien e qytetarëve. Për të arritur përparim të qëndrueshëm dhe të ndjeshëm në këtë bashki, është e domosdoshme që të prioritetizohet investimi në fusha të tjera kyçe që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe zhvillimin ekonomik. Prioritet për zhvillimin e qytetit duhet të jenë investimet në infrastrukturën rrugore, hapësirat publike, dhe veçanërisht në zhvillimin e turizmit bujqësor dhe kulturor. Kjo qasje do të krijojë një ekosistem të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, duke nxitur rritjen e turizmit dhe duke forcuar identitetin lokal, ndërkohë që përmirëson cilësinë e jetës së banorëve dhe çon në një zhvillim të qëndrueshëm të Belshit.

VI. DPP dhe Produktet

Bashkia Belsh ka plotësuar Deklaratën e Politikës së Programit sipas programeve buxhetore si edhe shpenzimet e produkteve sipas programeve. Tek Raporti: PBA7 - Shpenzimet e Produkteve të Programit, të rishikohen emërtesat për produktet si vijon:

- V043AAI-Mbështetje për aktivitetet sociale;
- V043-BL-001-Mbështetje për aktivitetet sociale;
- V328AAA-Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri;
- V314AAA - Shërbimi i policisë bashkiake;

- V424AAA - Shërbimi i mirëmbajtjes së Kanaleve të Ujitjes dhe Kullimit.

Produktete dhe emërtesat e tyre duhet të jenë në përputhje të plotë me listën e produkteve sipas shtojcës 5, të udhezimit vjetor për përgatitjen e PBA-së.

Gjithashtu të rishikohen kodet e produkteve si më poshtë:

- V328-BL-001-Shërbime të Mbrojtjes Civile;
- V626AAE-Varreza të mirëmbajtura.

Kodet e produkteve duhet të jenë në përputhje të plotë me kodet sipas shtojcës 5, të udhezimit vjetor për përgatitjen e PBA-së.

Gjatë fazës së dytë të rishikohen ato produkte të cilat janë të fragmentuara përshembull kanë financim vetëm në vitin 2028.

Po ashtu të planifikohen shpenzime për produktet të cilat kanë parashikuar sasi por jo fonde buxhetore në dispozicion për realizimin e tyre, si përshembull, rasti i produktit “V422AAD - Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor” apo “V637AAA - Kanalizime të Ujërave të Bardha të Mirëmbajtura”.

Gjithashtu, bashkia Belsh mund të kishte dhënë disa argumenta të faktorëve që kanë ndikuar në luhajten e kostove për njësi të produkteve të cilëve nuk ju ndryshon sasia nga njëri vit në tjetrin, por ju ndryshojnë kostot.

VII. Detyrimet e prapambetura si dhe parandalimi i tyre

Sipas raportimit, bashkia Belsh ka parashikuar planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2027. Ky veprim synon të minimizojë dhe të shmangë rrezikun që lidhet me bartjen e këtyre detyrimeve në periudhën afatmesme, duke përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të bashkisë dhe duke krijuar mundësi më të mira për menaxhim më efikas të burimeve financiare në të ardhmen.

VIII. Rekomandime

Roli kryesor i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) është të sigurojë që politikat, objektivat dhe qëllimet të jenë të qarta dhe të përcaktuara në mënyrë të saktë, ndërsa produktet e planifikuara të synojnë realizimin e tyre në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive, duke garantuar një përdorim optimal të fondeve buxhetore.

Bashkia Belsh ka bërë përpertime të konsiderueshme në këtë drejtim, duke përcaktuar programet e veta sipas metodologjisë së re, objektivat dhe qëllimet e politikës së programit, si dhe treguesit e performancës në nivel objektiv. Gjithashtu, janë identifikuar produktet përkatëse, është kryer kostimi i tyre dhe janë detajuar shpenzimet sipas kategorive të produkteve.

Duke vlerësuar pozitivisht angazhimin dhe punën e deritanishme të bashkisë Belsh, inkurajohet vijimi i punës për fazën e dytë të PBA-së.

Kjo fazë duhet të përqëndrohet në:

- Rishikimin e strukturës së zërave të shpenzimeve, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e buxhetit shkon për shpenzime personeli, ndërsa investimet zënë një peshë më të ulët, sipas komenteve të bëra për pjesën e investimeve në sesionin IV.
- Rishikimin e luhatjeve të kostove të produkteve në përputhje me komentet e dhëna në sesionin VI.
- Rishikimin e emërtesave të produkteve të përmendura në sesionin VI të cilat duhet të jenë në përputhje të plotë me listën sipas shtojcës 5, të udhëzimit udhëzimin nr.8, datë 28.02.2025, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028".
- Rishikimin e kodeve të produkteve të përmendura në sesionin VI.
- Rishikim për planifikim të fondeve në dispozicion për produktet që kanë të parashikuara sasi po jo fonde për realizimin e tyre.

Gjithashtu, nxisim vijimin e angazhimit të anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP) dhe drejtuesve të tij, në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në udhëzimin standard dhe shtojcën 7 të udhëzimit vjetor për përgatitjen e PBA-së për periudhën 2026–2028. Kjo është e nevojshme për të garantuar një dokument përfundimtar cilësor, gjithëpërfshirës dhe në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi.

Së fundmi, rekomandojmë që në fazën e dytë të PBA-së të reflektohen të gjitha komentet dhe sugjerimet e dhëna nga Ministria e Financave, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të dokumentit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike.

Tabela 1: Parashikimi i të ardhurave afatmesme të Njësië së Vetëqeverisjes Vendore							
Emertimi		Njësia e vetëqeverisjes Vendore					
Bashkia e Belsh		në lekë					
Nr	Emertimi i të Ardhurave Tashmë	Fakti i vitit 2023	Fakti i vitit 2024	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027	Parashikimi për vitin 2028
I.	Te ardhura nga taksa	37,328,922.00	39,527,937.00	64,799,500.00	64,431,400.00	64,083,000.00	62,515,200.00
1	Taksa mbi Ndetesat	8,945,630.00	8,573,544.00	15,440,000.00	15,756,000.00	15,912,000.00	16,068,000.00
2	Taksa mbi tokën bujqësore	14,762,800.00	14,825,345.00	34,069,500.00	33,060,000.00	32,000,000.00	32,000,000.00
3	Taksa e fjetjes në hotel	-	-	-	-	-	-
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,699,346.00	2,270,931.00	2,700,000.00	2,750,000.00	3,000,000.00	3,250,000.00
5	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësive	-	-	-	-	-	-
6	Taksa vjetëse e mjeteve të përdorura	7,736,722.00	8,674,141.00	8,650,000.00	8,800,000.00	8,960,000.00	9,200,000.00
7	Taksa për zënim të hapësirë publike	3,354,444.00	2,684,140.00	2,400,000.00	2,465,000.00	2,551,000.00	2,597,000.00
8	Taksa e obelës	250,955.00	171,425.00	210,000.00	253,000.00	264,500.00	276,000.00
9	Taksa e parkimit	-	-	-	-	-	-
10	Taksa e rentes misionare	-	-	-	-	-	-
11	Taksa vendore për blerësit e vegjël	118,750.00	17,900.00	20,000.00	20,200.00	20,400.00	20,600.00
12	Taksa tregu	180,893.00	191,148.00	200,000.00	212,200.00	224,000.00	236,600.00
13	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	195,556.00	40,136.00	90,000.00	99,000.00	103,500.00	108,000.00
14	Taksa e gjelbër	-	-	-	-	-	-
15	Të tjera	95,896.00	59,425.00	60,000.00	66,000.00	67,000.00	68,000.00
II.	Te ardhura nga Tarifat	17,487,174.00	19,281,571.00	26,297,000.00	26,719,000.00	26,654,200.00	31,249,700.00
1	Tarifë për pastrim	8,171,631.00	10,091,935.00	15,300,000.00	16,776,100.00	17,440,500.00	18,271,000.00
2	Tarifë për hapësirë publike	-	-	-	-	-	-
3	Tarifë vendore për ujë	140,750.00	144,305.00	145,000.00	155,500.00	172,500.00	180,000.00
4	Tarifë ndërtimi rrugor	1,240,589.00	1,350,454.00	3,000,000.00	3,300,000.00	3,450,000.00	3,600,000.00
5	Tarifë tregu	-	-	-	-	-	-
6	Tarifë gjelbër	936,227.00	256,426.00	300,000.00	341,000.00	356,500.00	372,000.00
7	Tarifë për reklame	-	-	-	-	-	-
8	Tarifë për leje transporti	319,960.00	156,510.00	180,000.00	213,000.00	264,500.00	276,000.00
9	Tarifë për shërbim të bagetive	-	-	-	-	-	-
10	Tarifë për shërbime të tjera administrative	4,226,700.00	3,008,078.00	4,200,000.00	4,266,000.00	4,269,000.00	4,272,000.00
11	Tarifë për shërbime sociale (arim parashkolle, konvikte)	-	-	-	-	-	-
12	Spese dhe kultura	-	-	-	-	-	-
13	Tarifë për veshetore	40,900.00	40,000.00	50,000.00	88,000.00	96,000.00	104,000.00
14	Tarifë të tjera nga D. Zhvillim Tërbim	1,964,617.00	3,381,108.00	3,144,000.00	3,438,400.00	3,521,200.00	4,067,200.00
15	Tarifë të tjera nga MNZSH	60,000.00	80,000.00	70,000.00	77,000.00	84,000.00	87,500.00
III.	Te ardhura nga shporta e pronës dhe dhënia me qira	928,698.00	1,238,678.00	1,172,500.00	1,185,235.00	1,196,970.00	1,278,765.00
1	Shporta Ndetesë	-	-	-	-	-	-
2	Shporta Tregu	-	-	-	-	-	-
3	Shporta të pronave të ndryshme	-	-	-	-	-	-
4	Qera tregu	759,450.00	1,090,910.00	1,000,000.00	1,010,000.00	1,020,000.00	1,100,000.00
5	Qera nga ndërtimet	165,648.00	147,768.00	172,500.00	175,235.00	176,970.00	178,765.00
6	Imetere nga të ardhurat	-	-	-	-	-	-
IV.	Te ardhura të tjera	9,803,478.00	9,712,888.00	8,630,000.00	8,716,200.00	9,462,600.00	9,631,400.00
1	Të tjera gjëra	11,000.00	57,000.00	50,000.00	50,500.00	51,000.00	51,500.00
2	Kamavotues	722,813.00	380,892.00	330,000.00	351,300.00	336,600.00	339,800.00
3	Tatim mbi të ardhurat personale	8,369,665.00	9,254,996.00	8,250,000.00	8,332,500.00	9,075,000.00	9,240,000.00
V.	Totali i të Ardhurave të Veta	64,744,672.00	69,863,074.00	101,090,000.00	103,051,935.00	104,396,850.00	104,975,005.00
1	Transferimi të Trashëgatisë nga I Kultur	41,664,559.00	48,340,542.00	-	-	-	-
2	Konk dhe Hën	0.00	0.00	-	-	-	-
3	Dhënia dhe sponsorizimi të ndryshme	0.00	0.00	-	-	-	-
4	Të ardhura të trashëguara nga vitet I Kultur	32,042,806.28	5,997,833.72	-	-	-	-
VI.	Totali i të Ardhurave të Veta (I+II+III+IV+V)	158,454,038.14	123,489,291.37	101,090,000.00	103,051,935.00	104,396,850.00	104,975,005.00
VII.	Te ardhura të kushtetuesara/ Pakushtetuesar	997,121,666.86	693,961,253.63	417,435,840.00	427,193,148.00	431,498,100.00	334,629,830.00
1	Transferimi të pakushtetuesara sektorale	65,021,464.00	130,607,266.00	122,323,056.00	119,679,049.00	99,679,049.00	88,679,049.00
2	Transferimi të kushtetuesar	264,440,797.00	402,355,342.00	111,388,318.00	107,042,369.00	107,042,369.00	107,042,369.00
3	Transferimi të pakushtetuesar	148,479,344.00	130,987,225.54	178,538,475.00	225,480,880.00	235,125,306.00	244,949,890.00
4	Fondi i Zhvillimit të Raportit Qeverisje Qendrore	510,821,561.00	-	-	-	-	-
TOTALI:		1,445,877,265.00	817,391,484.00	518,435,840.00	525,248,083.00	536,294,950.00	419,604,843.00
Mitrini		Emetuesi i marrëzimit të programit		Secretar i GMS	Rrëpunuesi Administrues		Secretar i GMS
Emri:		Alban Nijoli		Mustafa Çetani	Arti TAFANI		Mustafa Çetani
Mendimet:							
Data:							

Njësia Vendore: BASHKIA BELSH
Planifikimi I shpenzime per PBA 2026 - 2028

© 2004 Blackwell Publishing Ltd, *Journal of Internal Medicine* 255: 111–118

[illegible]

	Mandat	Organisasi / Nama / NPI di prosiding	Sekretaris / DRS	Pengantar / Pengantar
Basis		Majelis Gereja	Albino Maruli	Adi Satrio
Penyusunan:				
Tanggal:				